



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të neneve 13.7, 14.7, lidhur me nenin 16.2, dhe neneve 19.2 dhe 33 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 03.07.2003, të shpallur sipas Rregullores nr. 2003/30, dt. 10.09.2003; të nenit 3 par. 1, pika b, të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000; të nenit 19 par.1, pika b, dhe të nenit 40, par. 3, pika II të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2006, merr

V E N D I M **PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES** **“QYTETI I VJETËR” NË PRISHTINË**

Neni 1

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues “ Qyteti i vjetër” në Prishtinë.

Neni 2

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues është rregullimi i hapësirës dhe urbanizimi, dhe mbrojtja e vlerave të trashëgimisë historike, kulturore dhe ambientale, sipas destinimeve të planifikuara me Planin strategjik-Zhvillimi urban i Prishtinës, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, të dt. 2.7.2004, brenda kufijve të përshkruar me nenin 3 të këtij Vendimi.

Neni 3

Me Planin rregullues, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet hapësira e emërtuar si “Qyteti i Vjetër”, e cila në anën jugore përkufizohet me rrugën. “Zenel Salihu”, në anën lindore me rrugët “Afrim Loxha”, dhe ”Xheladin Kurbaliu”, pastaj me rr.”Haxhi Zeka”, rr “Llapi”deri te udhëkryqi me rr.”Lidhja e Prizrenit”, duke vazhduar në të majtë me rrugën .”Ilir Konushëfci”, dhe duke mbyllur hapësirën me rr. “Zenel Salihu”, e cila përfshinë një sipërfaqe të përafërt prej 26 ha.

Kufijtë e përshkruar të hapësirës, nga par.1 i këtij neni, janë të paraqitura në pjesën grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Hartimi i planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do t’i besohet personit juridik profesional, të përzgjedhur konform dispozitave të Ligjit mbi prokurimin.

Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë të Komunës së Prishtinës, do të kryejnë veprimet e nevojshme nga përgjegjësitë e tyre të caktuara për hartimin e Planit rregullues sipas këtij Vendimi.

Drejtoratet tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, janë të obliguara që t'i sigurojnë dhe t'i dërgojnë shënimet e kërkuara nga Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë, të cilat konsiderohen të nevojshme për hartimin e Planit rregullues sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Mjetet financiare për hartimin e Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Miratimi përfundimtar i Planit rregullues, të finalizuar sipas këtij Vendimi, do të bëhet me Vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 NR. 35-591 më 27.12.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri